

URDHËR
Nr.477, datë 27.6.2011

**PËR MIRATIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PROCEDURËS SË HARTIMIT TË AKTIT
TË MIRATIMIT DHE AKTIT TË REFUZIMIT PËR APLIKIMET E LEJEVE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikave 5 dhe 10, germa “A3”, “A4”, “B3” dhe “B4” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”,

URDHËROJ:

1. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit, për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe shtyrjen e afatit të kësaj leje, përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

2. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve ndërtimore përshkruhen në aneksin 2 të këtij urdhri.

3. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve radioaktive dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave, është e njëjtë me aktin e miratimit të ministrit për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

4. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

5. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve ndërtimore dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, përshkruhen në aneksin 4 të këtij urdhri.

6. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve radioaktive dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave, është e njëjtë me aktin e miratimit të ministrit për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

7. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi-shfrytëzimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje përshkruhen në aneksin 5 të këtij urdhri.

8. Pas realizimit në QKL nga subjektet minerare të aplikimit për leje minerare kërkim-zbulimi dhe vlerësimit të këtij aplikimi nga ana e institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese, aktit të verifikimit, projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, programit minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe planit të rehabilitimit të zonës minerare, drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), që mbulon veprimtarinë minerare harton aktin e miratimit të lejes minerare, i cili pasi firmoset nga ministri, dërgohet në mënyrë elektronike në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), brenda afateve ligjore.

9. Pas realizimit në QKL nga subjektet minerare të aplikimit për leje minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, dhe vlerësimit të këtij aplikimi nga ana e institucionit të Agjencisë Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese, aktit të verifikimit, projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, programit të investimit për shfrytëzimin ose kërkim-zbulim-shfrytëzimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe planit të rehabilitimit të zonës minerare, drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), që mbulon veprimtarinë minerare harton aktin e miratimit të lejes minerare, i cili, pasi firmoset nga ministri, dërgohet në mënyrë elektronike në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) brenda afateve ligjore.

10. Për lejet minerare, vendimi përfundimtar i miratimit të lejes njoftohet dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, sipas legjislacionit në fuqi, data e publikimit konsiderohet data efektive e dhënies së lejes minerare.

11. Për lejet që përfshijnë shfrytëzimin, vendimi përfundimtar i miratimit, përveç rasteve kur parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave ose nga Kuvendi, njoftohet nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, data e publikimit konsiderohet data efektive e dhënies së lejes minerare.

12. Për rastet e parashikuara në pikën 5 të nenit 15; pikën 10, neni 24 dhe pikën 6, neni 26 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, kur kërkohet që zona e lejuar e shfrytëzimit të hiqet nga fondi pyjor e kullosor, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtoria përkatëse në METE, që mbulon veprimtarinë minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço